



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Psikolinguistikë

Ngarkesa: 4 Kredite (= 40 orë mësimore); **Leksione:** 1.5 Kredite (= 15 orë mësimore); **Seminare:** 2.5 Kredite (= 25 orë);

Viti / Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave, Mësuesi e Gjuhës Angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Të ofrojë një hyrje të strukturuar në psikolinguistikë si fushë ndërdisiplinore që lidh gjuhësinë me psikologjinë dhe neuroshkencën. Të nxisë kuptimin e mënyrës sesi përvetësohet, kuptohet dhe prodhohet gjuha nga mendja e njeriut. Të krijojë bazat për të kuptuar proceset psikologjike që qëndrojnë pas përdorimit të gjuhës, me fokus te përvetësimi i gjuhës amtare dhe të huaj.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohin dhe të analizojnë lidhjen ndërmjet trurit dhe gjuhës, si dhe ndikimin e proceseve kognitive në përvetësimin e gjuhës.
2. Të zhvillojnë njohuri mbi proceset e perceptimit të të folurit, leksikun, përvetësimin e fjalive dhe kuptimin e ligjërimit.
3. Të identifikojnë ndikimin e bilingualizmit, kulturës dhe dykuptimësisë në prodhimin dhe kuptimin e gjuhës.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kursit studentët do jenë të aftë:

1. Të njohin dhe analizojnë çështjet kryesore lidhur me perceptimin e të folurit, njohjen leksikore, ndarjen e fjalive dhe të tekstit në pjesësi dhe përvetësimin e gjuhës dhe aftësive të leximit.
2. Të përshkruajnë dhe shpjegojnë çështjet më të rëndësishme të lidhjes së trurit me gjuhën dhe se si gjuha përftohet, përpunohet dhe ruhet.
3. Të kuptojnë lidhjen midis gjuhësisë së zbatuar, për fjalitë të gjuhës së huaj dhe psikolinguistikës.